

AKT THEMELUES

I SHOQERISE TREGTARE PRIVATE

“ J omorfia ”

Unë Joana Gjika, e bija e Sotirit, dtl 07.06.1998, me numer personal J85607052Q, banues Rr: Vedat Kokona 14, Tirane

Dhe

Unë Rei Kaci, i biri I Arjanit, dtl 11.03.1997, me numer personal J70311047D banues ne Kompleksi Orion 3 Rr Dibres, Tirane

Mbështetur në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ” dhe në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”, sot më datë 22.09.2022, krijojme shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “J omorfia ”, me aktin themelues të saj si vijon :

FORMIMI


NENI 1

Formohet shoqëria private e quajtur “ J omorfia” Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2



Selia e shoqërisë tregtare private "J omorfia". do të jetë :
Njesia bashkiake nr 4, Rruga e Dibres, Kompleksi Orion 3, njesia nr 4, Tirane
Ajo mund të çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organve kompetente edhe jashtë vendit.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e ortakut themelues të saj.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në fushën e:
Import-eksport, shitje me shumice dhe pakice të produkteve farmaceutike, kozmetike etj.
Tregtimit me shumicë e pakicë dhe import-eksport të mallrave industriale, ushqimore, lëndë të para. Import Eksport të Pajisjeve mjekesore.

NENI 4

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të sigurojë mjetet e nevojshme dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5



Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare private "J omorfia" do të jetë **10,000** (dhjet mijë) lekë dhe do të përbëhet nga kuotat e ortakëve themelues të shoqërisë. Kapitali përbëhet nga **2** kuota dhe vlera nominale e një kuote është e barabartë me **5,000** lekë.

Znj. Joana Gjika zotron 1 kuote me vlerë 5,0000 leke qe perbene 50% te kapitalit themeltar



Z. Rei Kaci zotron 1 kuote me vlere 5,000 leke qe perbene 50% te kapitalit themeltar

Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet sipas vendimit të ortakeve themelues. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

NENI 7

Ortaku i vetëm duhet të bëjë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajë sekretin e saj dhe të mos dëmtojë interesat e personave të tjerë dhe të shoqërisë.

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 8

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, Znj. Joana Gjika , e cila është përfaqësuese ligjore e saj. Afati i emërimit të administratorit është për një periudhë kohore prej 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

NENI 9

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakeve themelues të shoqërisë, Znj. Joana Gjika dhe Z.Rei kaci 50/50.

NENI 10



Ortaku themelues ka të drejtë të emërojë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale të shoqërisë. Ai ka të drejtë të caktojë financiar, likuidator për problemet e shoqërisë, si edhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të shoqërisë.

NENI 11

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykohen dhe zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 12

Shoqëria ka vulën e saj në madhësi të zakonshme, me tekstin për rrethin e saj.



NENI 13

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ".

NENI 14

Ky akt themelimi përpilohet në tre kopje me vlerë të barabartë, nga të cilat njëra depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, njëra në zyrën e Tatimeve dhe kopja e tretë mbahet në dokumentat e shoqërisë tregtare " J omorfia "

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaket themelues.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

"J omorfia"

JOANA GJIKA



REI KACI

